



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, STANDARDIZIMIT, PROTOKOLL-ARKIVIT

Nr. 21090 prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 1457, datë 28.10.2025

PËR
MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN E “POLITIKËS SË CILËSISË” SIPAS KËRKESAVE
TË STANDARDEVE ISO.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “o” të nenit 12 të Statutit të DPSHTRR-së,

URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit “Politika e Cilësisë” e DPSHTRR-së, e hartuar në përputhje me kërkesat e standardeve ISO, në dy gjuhë shqip dhe anglisht.
2. Publikimin e dokumentit “Politika e Cilësisë” e DPSHTRR-së në faqen zyrtare të Institucionit www.dpshttr.gov.al, në rubrikën “Transparenca”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Standardizimit dhe Protokoll – Arkivit dhe Njësia e Marrëdhënieve me Publikun për ndjekjen e procedurave përkatëse.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë!


DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Endri HAXHIU



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati Bjorn, Tiranë AL,1010;
Tel.: +355 68 801 5833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al



Misioni ynë

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 343, dt. 21.07.1999, në zbatim të Ligjit Nr. 8378, dt. 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si institucion shtetëror, me statusin e personit juridik, publik, me vetëfinancim.

DPSHTRR ka si objekt veprimtarie shërbimin ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, shërbim që e ofron përmes 13 drejtorive rajonale dhe nënzyrave të shërbimit të transportit rrugor për veprimtaritë:

- Regjistrimin e mjeteve (pajisjen e tyre me targa, leje qarkullimi, regjistrimin e pronarëve të tyre, pajisjen me certifikatën e errësimit të xhamave, licencimin dhe certifikimin e mjeteve etj.), lëshimin e certifikatës së njohjes, pajisjen me targë Retro për koleksion dhe targë Retro për mjet, si dhe lëshimin e autorizimit të lëvizjes për mjetet e hershme dhe me karakter historik (RETRO), kryerjen e procedurave ligjore për ndryshimin e pronësisë së mjeteve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Monitorimin e kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore dhe pajisjen e tyre me leje drejtimi, si dhe përmirësimin e kapacitetit institucional dhe njerëzor në fushën e sigurisë rrugore;
- Kontrollin teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore, nëse me ligj nuk është vendosur ndryshe;
- Krijimin e regjistrit elektronik kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre, si dhe transmetimin e të dhënave që kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj;
- Kryerjen e veprimtarisë së agentit tatimor, sipas përcaktimeve ligjore;
- Dhënien e lejeve të veprimtarisë së autoshkollave, dëshmitë e taksistit, instruktorëve të praktikës, teorisë etj.;
- Trajnimin e specializuar në fushat e transportit rrugor, për pajisjen e aplikantëve me dëshminë e aftësisë profesionale;
- Mbikëqyrjen e kualifikuar dhe zhvillimin e zgjidhjeve të integruara për administrimin, si dhe monitorimin e operatorëve të transportit rrugor, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre;
- Çdo objekt tjetër veprimtarie në shërbimin e transportit rrugor të lejuar nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi;
- Kryerjen e veprimtarisë së agentit në sigurime, sipas përcaktimeve ligjore;
- Kryerjen e veprimtarisë së agentit për arkëtimin e masave administrative, të vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe policisë së shtetit, sipas akt marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve dhe përcaktimeve ligjore në fuqi;

- Zhvillimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe panairë sipas objektit të veprimtarisë së DPSHTRR-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) synon të ofrojë shërbime të cilësisë së lartë dhe të besueshme në fushën e automotorizmit, për të përmirësuar sigurinë dhe për të garantuar regjistrimin e mjeteve rrugore sipas kërkesave ligjore dhe teknike në fuqi.

Angazhimi për Cilësi

Nëpërmjet certifikimit me standardet **ISO 9001:2015** për menaxhimin e cilësisë dhe **ISO 45001:2018** për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, DPSHTRR angazhohet të sigurojë shërbime që përmbushin pritshmëritë e qytetarëve tanë, duke vendosur cilësinë dhe sigurinë në qendër të çdo procesi.

Objektivat Kryesore të Cilësisë:

- **Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve:** DPSHTRR synon përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha proceseve për të rritur kënaqësinë e qytetarëve, të përmirësojë efikasitetin operacional dhe të rrisë besueshmërinë e institucionit.
- **Siguria dhe Shëndeti në Punë:** Sigurimi i një ambienti pune të sigurt për të gjithë punonjësit tanë është thelbësor për ne dhe përputhet me kërkesat e standardit ISO 45001:2018, për rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë në punë.
- **Respektimi i kërkesave ligjore dhe standardeve ndërkombëtare:** Duke qenë të akredituar sipas standardeve **ISO 17020:2012** - Trupë inspektuese dhe **ISO 17024:2012**- Trupë Certifikuese, ne garantojmë përputhshmërinë e plotë me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë ndërkombëtare për shërbimet tona të inspektimit dhe certifikimit.

Angazhimi për Transparencë dhe Integritet

Në të gjitha shërbimet tona, DPSHTRR ndjek parimet e transparencës, integritetit dhe pavarësisë së procesit të inspektimit dhe certifikimit të personelit, duke siguruar një proces të drejtë dhe të paanshëm për të gjitha palët.

Përmirësimi i Vazhdueshëm

Angazhohemi për të përmirësuar vazhdimisht sistemin tonë të menaxhimit të cilësisë, përmes identifikimit dhe implementimit të masave përmirësuese. Mbështesim zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve të rregullta, të cilat përputhen me standardet më të larta në shërbim.

Angazhimi ndaj Komunitetit dhe Mjedisit

Duke ofruar shërbime që kontribuojnë në rritjen e sigurisë rrugore dhe mjedisore, Institucioni jonë

përpiqet të ndikojë pozitivisht në komunitet përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit për përdoruesit e mjeteve, por edhe në mjedis për lehtësimin e procedurave për mjete ekologjike dhe të sigurta në rrugë.

Rishikimi dhe Përmirësimi i Politikës së Cilësisë


Politika e cilësisë do të rishikohet rregullisht për të siguruar që ajo mbetet e përshtatshme dhe efektive, duke reflektuar ndryshimet sipas nevojave të qytetarëve/marrësve të shërbimeve kërkesave ligjore dhe zhvillimeve teknologjike të vazhdueshme.

Kjo politikë është pjesë e dokumentacionit të Institucionit dhe është e aksesueshme për të gjithë punonjësit dhe klientët tanë përmes faqes zyrtare të internetit dhe zyrave tona.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Endri HAXHIU



 <p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR</p>	<h1>QUALITY POLICY</h1>	Code: FMC-01 Reviewed: 02 Date: 14.10.2025
		Page:1 from 3

Our mission

The General Directorate of Road Transport Services (GDRTS) was established by Decision of the Council of Ministers No. 343, date 21.07.1999, pursuant to Law No. 8378, date 22.07.1998 “Road Code of the Republic of Albania”, amended, as a state institution with the status of a public legal entity, which is entirely self-financed.

The scope of the activity of DPSHTRR/GDRTS, is to provide service to physical and legal entities, state and private ones, regarding the road transport activity. This service is offered through 13 Regional Directorates and Sub-Offices of the road transport service for the following activities:

- Registration of vehicles (equipping them with license plates, registration certificate, registering their owners, equipping them with a certificate of window tinting, licensing and certification of vehicles, etc.), issuing a certificate of recognition, equipping them with Retro license plates for collections and Retro license plates for vehicles, as well as issuing movement authorizations for vintage and historical vehicles (RETRO), carrying out legal procedures for the transfer of vehicles’ ownership, in accordance with the applicable laws and regulations;
- Monitoring the qualification of road transport vehicle drivers and providing them with driving licenses, as well as improving institutional and human capacity in the field of road safety;
- Mandatory technical inspection of road vehicles, unless otherwise provided by law;
- The creation of a national digital registry of vehicles and their drivers, as well as the transmission of data requested by the authorities designated by law;
- Carrying out the activity of a tax agent, according to legal provisions;
- Issuing driving school activity permits, taxi driver certificates, practical and theoretical instructors’ certificates, etc.;
- Specialized training in the area of road transport, to provide applicants with certificate of professional competence;
- Qualified supervision and the development of integrated administrative solutions, as well as the monitoring of road transport operators during the conduct of their activities;
- Any other activity in the road transport service permitted by the applicable law and by-law acts;
- Carrying out the activity of an insurance agent, according to legal provisions;
- Carrying out the activity of the agent for the collection of administrative penalties imposed by local government units and the state police, according to the agreements concluded between the parties and the legal provisions in force;

- Development and participation in activities and different fairs that apply activities according to the scope of activity of the DPSHTRR/GDRTS.

The General Directorate of Road Transport Services (DPSHTRR/ GDRTS) aims to provide high-quality and reliable services within the field of automotives, to improve safety and to guarantee the registration of road transport vehicles according to applicable legal and technical requirements.

Commitment to Quality

Through certification with **ISO 9001:2015** standards for quality management and **ISO 45001:2018** for occupational health and safety management, DPSHTRR/ GDRTS is committed to providing services that meet the expectations of our citizens, placing quality and safety at the core of every process.

Main Quality Objectives:

- **Continuous improvement of service quality:** DPSHTRR/ GDRTS aims at continuous improvement of all processes to increase citizens' satisfaction, improve operational efficiency and increase the credibility of the institution.
- **Occupational Safety and Health:** Providing a safe working environment for all our employees is essential to us and complies with the requirements of the ISO 45001:2018 standard, in order to increase awareness of occupational safety.
- **Compliance with legal requirements and international standards:** Being accredited according to **ISO 17020:2012** - Inspection Body and **ISO 17024:2012** - Certification Body standards, we guarantee full compliance with legal requirements and international quality standards for our inspection and certification services.
- **Commitment to Transparency and Integrity**

In all our services, DPSHTRR/ GDRTS follows the principles of transparency, integrity and independence of the personnel inspection and certification process, ensuring a fair and impartial process for all parties.

Continuous Improvement

We are committed to continuously improving our quality management system, through the identification and implementation of improvement measures. We support the professional development of staff through regular training, which complies with the highest standards in service.

Commitment to the Community and the Environment

Our Institution by providing services that contribute to increasing road and environmental safety, strives to positively impact the community through raising awareness, educating vehicle users, and at the same time tries to contribute also on the environment by facilitating procedures for ecological and safe vehicles on the road.

Review and Improvement of the Quality Policy

The quality policy will be regularly reviewed to ensure that it remains relevant and effective, reflecting changes based on the needs of citizens/service recipients, legal requirements and ongoing technological developments.

This policy is part of the Institution's documentation and is accessible to all our employees and clients through the official website and our offices.

GENERAL DIRECTOR

Endri HAXHIU

